



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1313 Prot.

Tiranë, më 24.06.2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 47 Datë 24.06 2026

**“PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË CIKLIT TË
DYTË "MASTER PROFESIONAL" NË “TRAJNIMI SPORTIV DHE TË
USHQYERIT”, ME DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË
SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË LËVIZJES DHE
UNIVERSITETIT EVROPIAN TË MADRIDIT”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në LAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimin nr.310 datë 11.05.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 7, 43, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 24 të Rregullores së UST-së, shkresën nr. 606/8 prot., datë 23.06.2026 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes "Propozim për kodifikimin e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Trajnimi Sportiv dhe të Ushqyerit", shkresën e Ministrisë së Arsimit nr. 4516 prot., datë 11.06.2026 "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve", në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik nr. 93 dt 24.06.2026, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 24.06.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të ciklit të dytë Master Profesional në "Trajnimi Sportiv dhe të Ushqyerit", me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Universitetit Evropian të Madridit.
2. Efektet financiare që burojnë nga kjo marëveshje do të miratohen në buxhetin e cdo viti.

3. Programi i përbashkët i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze.
4. Kodi i programit të përbashkët të studimit është P71MP1014A (shkresa bashkëlidhur).
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

